

PROKURORIA PUBLIKE E QARKUT

PP. nr .115/2000

Me datën 21.09.2000

Gj i l a n

GJYKATËS SË QARKUT

Gjilan

Në bazë të nenit 45, paragrafi 2, pika 3 e LPP ngrit

A K T A K U Z Ë

Kundër:

MOMQILLO TRAJKOVIQIT, emri i babait, ■■■■■, i nënës ■■■■■ i vajzërisë ■■■■■, i lindur me datën ■■■■■ në fshatin Carakovce, me banim të përhershëm në Kamenicë, ■■■■■", p.n., serb, i martuar, baba i tre fëmijëve, i arsimuar, ish shef i stacionit policor në Kamenicë, me gjendje mesatare pronësore, i padënuar, zhvillohet procedurë penale në drejtim të veprës penale të vrasjes nga neni 30, paragrafi 1 i LPK në lidhje me nenin 19 të LPJ, si dhe armëmbajtjes pa leje ose lëndëve plasëse nga neni 199, paragrafi 3, në lidhje me paragrafin 1 të LPK, në PARABURGIM në 'Bondsteel " në Sojevë.

SEPSE

Në periudhën kohore prej datës 24.05.1999 e deri në ditën kritike të hyrjes së Forcave Ndërkombëtare në Kosovë, gjatë konfliktit të armatosur dhe bombardimit të paktit të NATO-s kundër RS të Jugosllavisë, i ka shkelur të drejtat e të së Drejtës Ndërkombëtare gjatë luftës në atë mënyrë që në cilësinë e Shefit të policisë së

Kamenicës, me iniciativën, me urdhrat dhe me veprimet e tij, duke i kryer urdhrat e niveleve më të larta, me paramendim dhe në mënyrë sistematike ka planifikuar, ka urdhëruar dhe ka kryer aksione kriminale kundër popullatës së paarmatosur civile si më poshtë: vrasje, ekzekutime, keqtrajtime, ka shkelur të drejtat e integritetit trupor, ka shpërngulur, i ka përdorur masat e frikës dhe të terrorit, i ka marrë njerëzit si pengje, i ka dënuar në mënyrë kolektive, e ka lënë popullatën në uri, ka rrëmbyer dhe plaçkitur pronën e banorëve të kësaj ane, në mënyrë “kundërligjore dhe arbitrare ka shkatërruar pronën, e cila nuk arsyetohet me nevojat ushtarake-policore, në atë mënyrë që e ka sajuar listën e njerëzve me emër e me mbiemër, të cilët janë marrë me aktivitete politike, sociale dhe humanitare në territorin e Kamenicës, lista të cilat, nën komandën e tij, ia ka dhënë policisë dhe iu ka urdhëruar që vet apo së bashku me forcat ushtarake, personat nga këto lista t’i privojnë nga jeta aty për aty, që më vonë edhe është vepruar ashtu dhe të gjitha këto veprime i ka kryer si më poshtë:

- Me datën 18 prill të vitit 1999, duke kryer urdhrin e tij si shef i tyre, forcat policore në bashkëpunim me forcat ushtarake herët në mëngjes i kanë rrethuar fshatrat: Strezovc, Ljeshtarë, Rahovicë, Krilevë dhe Gregjenik, të armatosur me pushkë automatike dhe me armatim tjetër të kalibrave të ndryshëm, kanë hapur zjarr nga të gjitha drejtimet dhe pandërprerë kanë zbratur rafale nëpër zonat dhe shtëpitë fshatare me qëllim që të shkaktojnë panik dhe tmerr tek popullata e paarmatosur civile duke i dëbuar me dhunë nga shtëpitë e tyre, kurse më vonë kanë filluar edhe me ekzekutime: privohet nga jeta A ■■■■ A ■■■■, 70 vjeçar nga fshati Gregjenik, A ■■■■ I ■■■■, 23 vjeçar nga Rahovica, të cilin e kanë vrarë në prag të shtëpisë dhe në prani të anëtarëve të familjes, Sh ■■■■ I ■■■■, 34 vjeçar, R ■■■■■ K ■■■■ nga fshati Karaçevë, i cili është kidnapuar në fshatin Rahovicë dhe i cili është privuar nga jeta në periferi të Kamenicës, kurse pas përfundimit të këtyre vrasjeve dhe dëbimit të popullatës civile, menjëherë e kryen aksionin kriminal të shkatërrimit të pronës, të plaçkitjes dhe në fund të djegies.

- Me datën 19 prill të vitit 1999, forcat ushtarake-policore, nën komandën e të akuzuarit Momqilo Trajković, herët në mëngjes e kanë rrethuar fshatin Petrovc, fshatin i cili numëron më shumë se 3000 banorë, me dhunë e kanë dëbuar gjithë popullatën

civile duke i dëbuar nga shtëpitë e tyre në drejtim të kufirit Kosovë-Maqedoni dhe, pas zbrazjes së fshatit, fillon aksionet kriminale të plaçkitjes së pronës, të djegies së shtëpive, kurse në pragun e shtëpisë së tyre, pa asnjë arsye, i kanë privuar nga jeta babën dhe djalin, M■■■■ dhe F■■■ Sh■■■, të cilët nuk kanë mundur me kohë të braktisin fshatin, në të cilin të dyja kufomat i kanë djegur me qëllim të shkatërrimit të gjurmëve.

- Me datën 11 maj të vitit 1999, forcat ushtarako-policore të drejtuara dhe nën komandën e Momqillo Trajkoviqit, me lista paraprakisht të përgatitura në duar, kanë rrethuar fshatrat: Hogosht, Koprivnicë, Sopasnicë, Krajnidel, Karaqevë e Epërme, Karaqevë e Poshtme, Rogaçicë, Odanovc, Topanicë dhe Koretin, ku më parë i kanë sajuar listat me emra e me mbiemra të njerëzve të cilët janë marrë me aktivitetin politik, social dhe humanitar, me qëllim të likuidimit të tyre për ç'arsye nga fshati Hogosht së pari e kanë kidnapuar R■■■■ L■■■ dhe M■■■■ S■■■■, ku të cilët në vendin e quajtur "Pishnajat" të fshatit Karaqevë pa asnjë arsye i kanë likuiduar, I■■■ I■■■ nga fshati Koprivnicë e kanë privuar nga jeta në prani të anëtarëve të familjes, N■■■■ K■■■■ nga fshati Rogaçicë e kanë privuar nga jeta vetëm pse nuk ka treguar se ku gjenden djemtë e tij pasi që ata kanë qenë në listat e ekzekutimit, nga fshati Karaqevë, nga shtëpia e tij e kanë marrë A■■■ Th■■■, të cilin më parë e kanë rrahur dhe keqtrajtuar rëndë në prani të familjes së tij dhe me makinë e kanë dërguar deri në stacionin policore në Kamenicë, e më vonë, me urdhrin e shefit nisen për Prishtinë dhe privohet nga jeta nga duart e Zh■■■ F■■■ "P■■■" dhe S■■■ A■■■ tek liqeni i Badovcit në afërsi të Prishtinës, kurse në të njëjtën ditë në fshatin Karaqevë në shenjë të hakmarrjes e kanë djegur shtëpinë e M■■■ K■■■, pasi që djali i tij, B■■■, nuk ka qenë në shtëpi, kurse ka qenë në listën për likuidim, -

- Me datën 01.05. të vitit 1999, në vendin e quajtur "Qafa e hithrave", duke ekzekutuar urdhrat paraprake të të akuzuarit Momqillo Trajkoviq, forcat policore në bashkëpunim me ato ushtarake kanë vrarë: E■■■ J■■■■, nga fshati Dazdincë dhe R■■■■ S■■■■ nga fshati Feriqevë, madje në të njëjtin vend i urdhërojnë punëtorët e organizatës "Napredak" që t'i varrosin, -

- Me datën 11 prill të vitit 1999, i akuzuari Momqillo Trajković, në orët e pasdites në Kamenicë, personalisht, në krye të një grupi të armatosur policor dhe edhe vet i armatosur, ka hyrë në hapësirat e Auto shkollës "Jehona", e ka thirrur drejtorin e auto shkollës, H [REDACTED] R [REDACTED] dhe pasi që askush nuk është lajmëruar, e ka urdhëruar F [REDACTED] Sh [REDACTED] t'i gjejë çelësat e autobusit dhe të shtëpisë së H [REDACTED] ose do të djeg shtëpinë dhe autobusin, për çka midis ditëve 11 dhe 12 prill, rreth orës 1,00, ka djegur autobusin dhe shtëpinë ku, si pasojë, janë djegur shtëpia, autobusi dhe hapësirat e tjera përcjellëse. -

- Me datën 18.4. të vitit 1999, në fshatin Krilevë, nga ana e forcave ushtarako-policore, me armë zjarri janë plagosur: Z [REDACTED] D [REDACTED], A [REDACTED] D [REDACTED] dhe B [REDACTED] S [REDACTED] nga (këtu, në dokumentin në gjuhën serbe, mungon teksti i mëtejme, me të cilin mund të përmbylej fjalia ose informacioni – vërejtje e përkthyesit)

- Me datën 17.4. të vitit 1999, në Kamenicë, nga ana e forcave ushtarako-policore, me armë zjarri janë plagosur Xh [REDACTED] L [REDACTED], G [REDACTED] L [REDACTED] dhe V [REDACTED] Sh [REDACTED], të gjithë nga Kamenice, -

- Me datën 3. 04. të vitit 1999, në Kamenicë, nga ana e forcave ushtarake dhe policore, rreth orës 1,00, në oborrin e I [REDACTED] B [REDACTED] është hedhur një granatë dore e cila ka shpërthyer dhe, si pasojë, janë plagosur rëndë I [REDACTED] B [REDACTED] dhe A [REDACTED] B [REDACTED]. –

- Me datën 01. 04. të vitit 1999, në Kamenicë, nga ana e forcave policore, me armë zjarri janë plagosur: M [REDACTED] dhe R [REDACTED] R [REDACTED], në pjesën e shpinës dhe të krahërorit të djathtë, -

- Me datën 4. 05. të vitit 1999, në Kamenicë, nga ana e forcave ushtarako-policore, në prag të shëtisë është plagosur A [REDACTED] K [REDACTED], -

- Me datën 20. 05. të vitit 1999, në fshatin Koretin, nga ana e forcave ushtarako-policore, nga armë të zjarrit, janë plagosur: S [REDACTED] S [REDACTED], H [REDACTED] H [REDACTED] dhe Xh [REDACTED] R [REDACTED], -

- Me datën 11. 05. të vitit 1999, në fshatin Odanovc, në pjesën e quajtur "Batalit", deri sa po udhëtonin me automobilin e tyre të tipit "Lada niva", nga armët e forcave policore, janë plagosur Sh [REDACTED] B [REDACTED] dhe H [REDACTED] Sh [REDACTED], -

- Me datën 17. 05. të vitit 1999, forcat policore, sipas urdhrimit të të akuzuarit, në fshatin Topanicë, nga shtëpia e tij e kanë marrë R [REDACTED] M [REDACTED], e kanë dërguar në stacionin policor dhe pa asnjë arsye e kanë rrahur, maltretuar dhe keqtrajtuar në mënyrë të vrazhdë deri në humbje të vetëdijes, -

- Me datën 17 prill të vitit 1999, rreth orës 10,00, në fshatin Krilevë, nga ana e forcave ushtarako-policore është kidnapuar H [REDACTED] D [REDACTED] së bashku me një person tjetër me inicialet NN., derisa ka qenë duke vozitur automobilin e udhëtarëve të tipit "Pezho", duke e lëshuar fshatin, dhe i njëjti është dërguar në Novo Brdo, ku katër ditë me radhë është rrahur, është keqtrajtuar në mënyrë të vrazhdë, ku pas katër ditësh ia kanë zgjidhur duart dhe, duke e liruar, i kanë thënë që kurrë të mos kthehet, -

- Me çka ka kryer veprë penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile nga neni 142, paragrafi 1 i LPJ.

Prandaj:

// P r o p o z o j

Që para kësaj gjykate të caktohet séance gjyqësore kryesore, në të cilën thirren:

1 .

- Prokurori publik i qarkut në Gjilan,

- I akuzuari, Momqillo Trajkoviq, në paraburgim në burgun e "Bondstil" – Sojevë.

2.

Në cilësinë e dëshmitarëve dhe të të dëmtuarve për dëgjim:

1. - L [REDACTED] S [REDACTED], vendbanimi "[REDACTED] Prishtinë

2. - B [REDACTED] S [REDACTED], fshati Hogosht - Kamenicë,

3. - B [REDACTED] Gj [REDACTED], fshati Hogosht - Kamenicë,
4. - Z [REDACTED] I [REDACTED], f. Koprivnicë - Kamenicë,
5. - B [REDACTED] Th [REDACTED], f. Karaçevë e Ulët - Kamenicë,
6. - N [REDACTED] V [REDACTED], f. Rahovicë - Kamenicë,
7. - H [REDACTED] Th [REDACTED], f. Karaçevë e Ulët - Kamenicë,
8. - K [REDACTED] I [REDACTED], f. Rahovicë - Kamenicë,
9. - F [REDACTED] I [REDACTED], f. Rahovicë – Kamenicë,
10. - B [REDACTED] K [REDACTED], f. Petrovc - Kamenicë,
11. - Q [REDACTED] D [REDACTED], f. Ropotovë e Vogël - Kamenicë,
12. - M [REDACTED] I [REDACTED], f. Koprivnicë - Kamenicë,
13. - M [REDACTED] F [REDACTED], f. Gjuriševc - Kamenicë,
14. - B [REDACTED] F [REDACTED], f. Karaçevë - Kamenicë,
15. - I [REDACTED] S [REDACTED], f. Feriçevë - Kamenicë,
16. - S [REDACTED] S [REDACTED], f. Feriçevë - Kamenicë,
17. - Z [REDACTED] D [REDACTED], f. Strezovc - Kamenicë,
18. - S [REDACTED] I [REDACTED], f. Matiçan – Prishtinë,
19. - B [REDACTED] K [REDACTED], f. Karaçevë - Kamenicë,
20. - R [REDACTED] B [REDACTED], f. Hogoshte - Kamenicë,
21. - H [REDACTED] D [REDACTED], f. Kriljevo - Kamenicë,
22. - Sh [REDACTED] K [REDACTED], f. Karaqevë e Epërme - Kamenicë,
23. - A [REDACTED] K [REDACTED], f. Karaqevë e Epërme - Kamenicë,
24. - N [REDACTED] K [REDACTED], f. Karaçevë e Ulët - Kamenicë ,
25. - B [REDACTED] K [REDACTED], f. Rogaçicë - Kamenicë,
26. - M [REDACTED] R [REDACTED], f. Bratilovcë - Kamenicë,
27. - R [REDACTED] M [REDACTED], f. Topanicë - Kamenicë,
28. - L [REDACTED] K [REDACTED], f. Rogaçicë - Kamenicë,
29. - M [REDACTED] K [REDACTED], f. Rogaçicë - Kamenicë,
30. - B [REDACTED] K [REDACTED], fshati Karaçevë e Epërme - Kamenicë,
31. - M [REDACTED] B [REDACTED], fshati Strezovc – Kamenicë,
32. - Gj [REDACTED] K [REDACTED], rr. " [REDACTED] " Kamenicë,
33. - R [REDACTED] R [REDACTED], rr. " [REDACTED] " Kamenicë,

- 34.- Gj[REDACTED] L[REDACTED], rr. "[REDACTED]-Kamenicë,
- 35.- G[REDACTED] L[REDACTED], rr. "[REDACTED] - Kamenicë,
- 36.- F[REDACTED] Sh[REDACTED], rr. "[REDACTED]. – Kamenicë,
- 37.- I[REDACTED] B[REDACTED], rr. "[REDACTED] - Kamenicë,
- 38.- R[REDACTED] I[REDACTED], fshati Koprivnicë - Kamenicë,
- 39.- M[REDACTED] R[REDACTED], rr "[REDACTED] - "Kamenicë,
- 40.- A[REDACTED] K[REDACTED], rr. "[REDACTED] - Kamenicë,
- 41.- A[REDACTED] B[REDACTED], rr. "[REDACTED] - Kamenicë,
- 42.- S[REDACTED] S[REDACTED], rr." [REDACTED] - Kamenicë,
- 43.- H[REDACTED] H[REDACTED], fshati Koretin - Kamenicë,
- 44.- Xh[REDACTED] R[REDACTED], f. Koretin - Kamenicë,
- 45.- R[REDACTED] M[REDACTED], rr. "[REDACTED] – Prishtinë,
- 46.- F[REDACTED] K[REDACTED], rr. "[REDACTED]" - Kamenicë,
- 47.- T[REDACTED] I[REDACTED] - Kamenicë,
- 48.- Sh[REDACTED] I[REDACTED], fshati Koprivnicë - Kamenicë,
- 49.- B[REDACTED] S[REDACTED], f. Leshtarë - Kamenicë,
- 50.- A[REDACTED] D[REDACTED], f. Krilevë - Kamenicë,
- 51.- Z[REDACTED] D[REDACTED], f. Krilevë - Kamenicë,
- 52.- B[REDACTED] S[REDACTED], f. Leshtarë - Kamenicë,
- 53.- F[REDACTED] Th[REDACTED], f. Karaçevë e Ulët - Kamenicë,
- 54.- F[REDACTED] S[REDACTED], vendbanimi "[REDACTED] – Prishtinë,
- 55.- B[REDACTED] K[REDACTED], f. Rogaçicë - Kamenicë,
- 56.- B[REDACTED] K[REDACTED], f. Karaqevë e Epërme - Kamenicë,
- 57.- L[REDACTED] L[REDACTED], f. Petrovc - Kamenicë,
- 58.- T[REDACTED] K[REDACTED], f. Rogaçicë - Kamenicë,
- 59.- M[REDACTED] K[REDACTED], f. Karaçevë e Ulët - Kamenicë,
- 60.- Sh[REDACTED] B[REDACTED], f. Odanovc - Kamenicë,
- 61.- H[REDACTED] Sh[REDACTED], f. Poliçkë - Kamenicë,
- 62.- S[REDACTED] D[REDACTED], f. Shipashnicë e Epërme - Kamenicë,
- 63.- R[REDACTED] R[REDACTED], f. Koretinë - Kamenicë,
- 64.- H[REDACTED] R[REDACTED], rr. "Malësija" p.n, - Kamenicë,

65.- R [REDACTED] M [REDACTED], f. Topanicë - Kamenicë.

3.

Si prova materiale të sjellin:

- Raportin e SPB-së në Gjilan, i datës 27.04. 1999;
- Raportin e SPB-së në Gjilan, i datës 4.05.1999;
- Procesverbalin mbi kërkimin e vendit të ngjarjes nga ana e gjykatësit hetues nr. 36/1999;
- Procesverbalin mbi kërkimin e vendit të ngjarjes nga ana e gjykatësit hetues nr. 44/99;
- Procesverbalin e organizatës komunale "Napredak", nr. 64/99;
- Raportin mbi legjitimimin e personave, regjistrin e personave me emër dhe me mbiemër për likuidim të shkruar në gjuhën serbo-kroate, në alfabetin cirilik;
- Fletë lëshimin nr. 536 në emër të Xh [REDACTED] L [REDACTED];
- Raportin mjekësor në emër të I [REDACTED] B [REDACTED] nga Kamenica;
- Raportin mjekësor nr. 1873 në emër të R [REDACTED] R [REDACTED];
- Raportin mjekësor nr. 3193 në emër të Xh [REDACTED] R [REDACTED];
- Fletë lëshimin nr. 463 në emër të M [REDACTED] R [REDACTED];
- Raportin mjekësor me numër 9204 në emër të B [REDACTED] S [REDACTED];
- Raportin mjekësor me numër 9235 në emër të Z [REDACTED] D [REDACTED];
- Të bëhet shikimi i fotoalbumit të 6 fotografive në emër të R [REDACTED] M [REDACTED];
- Fotoalbumi i katër fotografive të shtëpisë së M [REDACTED] K [REDACTED];
- Të bëhet shikimi i fotoalbumit të 8 fotografive të shtëpisë dhe të autoshkollës "Jehona" në Kamenicë;

4.

Që pas përfundimit të seancës gjyqësore kryesore, dëgjimit të palëve në procedurën penale, paraqitjes së provave materiale dhe administrimit të tyre, i akuzuari, Momqillo Trajkoviç, të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit me dënimin e merituar.

A r s y e t i m

Gjatë zhvillimit të hetimeve kundër të akuzuarit Momqillo Trajkoviq nga Kamenica, janë siguruar provat, të dhënat dhe faktet, mbi bazën e të cilave është vërtetuar se i akuzuari në vendin, në kohën dhe në mënyrën e përshkruar në dispozitivin e akuzës, me paramendim ka kryer vepër penale, krime të luftës, kundër popullatës civile nga neni 142, paragrafi 1 i LPJ.

I akuzuari Momqillo Trajkoviq në mbrojtjen e tij, të dhënë gjatë procedurës hetimore, e ka refuzuar diapozitivat e kërkesës së zhvillimit të hetimit me arsyetimin se krimet, vrasjet, dëbimet, tentim vrasjet dhe shkelja e të drejtës ndërkombëtare gjatë luftës nuk i ka kryer dhe se në tërësi i refuzon si të pabaza.

Në mbrojtjen e tij, i akuzuari ka saktësuar se nga viti 1995 e deri më 10 qershor të vitit 1999 ka qenë shef i Sekretariatit për Punë të Brendshme në Kamenicë, se si shef i këtij sektori ka kryer punë administrative të organeve përkatëse dhe se është përgjegjës para D ■■■■■ G ■■■■■ nga Zrenjanini dhe se për të gjitha punët, të cilat i ka kryer, llogaritë i ka dhënë para tij.

Si shef i sektorit, nuk ka pasur kurrfarë mbikëqyrje mbi policinë, por e ka bërë mbikëqyrjen e tre punëtorëve, të cilët punonin punë administrative.

Më tej, në mbrojtjen e tij ka saktësuar se me datën 18. 4. të vitit 1999, kur me dhunë janë dëbuar banorët e fshatrave Strezovc, Leshtarë, Rahovicë, Krilevë dhe Gregjenik, dhe ku janë vlarë njerëzit, nuk ka qenë i njoftuar, ngaqë sigurimi publik nuk i ka takuar kompetencave të tij. Po ashtu është mbrojtur, madje në mënyrë të njëjtë, se nuk ka qenë i njoftuar me vrasjet e datës 11 maj të vitit 1999 godine, në fshatrat Hogosht, Koprivnicë, Shipashnicë, Krajnidel, Karaçevë e Epërme dhe e Poshtme, Rogaçicë, Odanovc, Topanicë dhe Koretin, banorët e të cilave janë dëbuar me dhunë nga shtëpitë e tyre kur edhe gjatë dëbimit janë privuar nga jeta dhe prona e tyre është plaçkitur, dhe se për gjithë këtë, vetëm për disa raste është njoftuar nga ana e disa familjarëve të atyre shtëpive.

Po ashtu në tërësi i ka mohuar edhe krimet, të cilat janë kryer me datën 19 Prill të vitit 1999 nga ana e forcave ushtarako-policore në fshatin Petrovc, në të cilin, pos dëbimit të popullatës civile, janë privuar nga jeta edhe dy persona, babai dhe djali i tij,

M■■■■ dhe F■■■ Sh■■■, se kufomat e tyre janë djegur, se nuk është i njoftuar dhe më tutje ka saktësuar se as për plagosjen e njerëzve, që ka ndodhur në Kamenicë dhe në rrethinën e Kamenicës po ashtu nuk ka qenë i njoftuar dhe po ashtu është mbrojtur se gjatë gjithë kohës deri sa ka zgjatur konflikti ka qenë në Kamenicë, në rroba civile dhe se nuk e ka bartur uniformën.

Mbrojtja e të akuzuarit është e pabazuar, ngaqë nuk ka mbështetje në asnjë provë të sjellë gjatë procedurës hetimore. Mbrojtja e këtillë është kontraverze dhe jologjike dhe nuk përputhet me dëshmitë e të dëmtuarve, me dëshmitë e dëshmitarëve, numri i të cilëve tejkalon shifrën prej 60 sish, e po ashtu edhe me provat materiale të siguruara gjatë zhvillimit të procedurës hetimore, siç janë protokollet mbi hulumtimin e vendit të ngjarjes, raportet mjekësore, lista e legjitimitit të identitetit personal, ku janë të nënvizuara emrat dhe mbiemrat e personave të paraparë për likuidim, fotoalbumet e fotografive, me fjalë të tjera e gjithë kjo vërteton anën e kundërt të mbrojtjes së tij, që mbrojtjen e tij e bëjnë të pabazuar, jologjike, se i akuzuari ka qenë në dijeni të plotë për të gjitha rastet dhe për të gjitha veprimet, të cilat i kanë ndërmarrë njerëzit e tij në bashkëpunim me forcat ushtarake dhe se në një mënyrë përpiket t'i ikën përgjegjësisë duke u thirrur në atë se ka kryer mbikëqyrjen vetëm mbi administratën, mbi bazën e vendit të punës, ku ka qenë i caktuar, fjala është për një person me obligime të veçanta, i cili jep urdhra dhe kryen urdhrat nga të mësipërmit në kuadër të ligjit, i cili ka qenë në fuqi, por të njëjtin e ka tejkualuar, kurse mbrojtjen e orienton me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale.

Janë evidente faktet se i akuzuari Momqillo Trajković, në kohën, në vendin dhe në mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të akuzës, me paramendim ka kryer veprë penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile nga neni 142 paragrafi 1 i LPJ.

Krimet, të cilat janë kryer mbi popullatën e paarmatosur civile, i vërtetojnë dëshmitë e të dëmtuarve L■■■ S■■■■, B■■■ Gj■■■■, Z■■■ I■■■, H■■■ Th■■■, K■■■ I■■■, B■■■ K■■■■, I■■■ S■■■■, S■■■ I■■■, H■■■ D■■■, B■■■ K■■■■, R■■■ M■■■, si dhe dëshmitarët e tjerë, të cilët në mënyrë të bindshme e shpjegojnë çdo hollësi të kësaj veprë penale, madje secili individualisht për gjithë atë çfarë kanë parë dhe përjetuar gjatë kësaj periudhe kohore deri sa ka zgjatur

konflikti i armatosur dhe që në mënyrë të drejtpërdrejtë janë ballafaquar sy më sy me policinë dhe ushtrinë, që kanë vepruar sipas urdhrave të marra nga i akuzuari.

Dëshmitari L ■■■ S ■■■ ka thënë se me datën 11 maj të vitit 1999, rreth orës 10,30, forca të mëdha policore e kanë rrethuar fshatin Hogosht dhe me lista në duar në këtë fshat e kanë marrë M ■■■ S ■■■ dhe të njëjtin e kanë privuar nga jeta te vendi i quajtur "Pishnajat" në afërsi të fshatit Karaçevë e Epërme, dhe po ashtu pas kidnapimit të babait të tij ia kanë djegur shtëpinë e tij.

B ■■■ Gj ■■■ ka dëshmuar se me 11 maj të vitit 1999, në fshatin Hogosht, në shtëpinë e saj kanë hyrë dy persona ushtarak me një listë në dorë dhe, pas legjitimitit të saj, e kanë kërkuar bashkëshortin e saj R ■■■ L ■■■, kurse në pyetjen e saj "përse e kërkoni këtë person" ata janë përgjigjur: "Merre plakun dhe largohu nga shtëpia, për arsye se bashkëshorti yt, R ■■■, ka gabuar shumë në jetën e tij", kur edhe asaj ia kanë treguar regjistrin, regjistër i cili ka qenë i shkruar në gjuhën serbe me alfabetin "cirilik", dhe në atë regjistër kanë qenë emrat dhe mbiemrat e tetë shqiptarëve, kurse njëri nga ushtarët i ka thënë asaj se burri i saj është për likuidim, për çka, të nesërmen, me datën 11 maj të vitit 1999, në mëngjes, është njoftuar se është likuiduar në vendin e quajtur "Pishnaja", në afërsi të fshatit Karaçevë, është marrë kufoma dhe varrimi është bërë në Hogoshtë, dhe po ashtu ajo ka saktësuar se njëri nga ushtarët ka qenë polic nga fshati Kmetovc.

Këto dhe të dhënat e tjera në deklaratat e tyre i vërtetojnë Z ■■■ I ■■■, B ■■■ Th ■■■, N ■■■ V ■■■, e cila dëshmon për gjithë rastin i cili ka ndodhur në fshatin Rahovicë, H ■■■ Th ■■■ për ngjarjen që ka ndodhur në fshatin Karaçevë me datën 11 maj të vitit 1999, nga shtëpia e tij është marrë A ■■■ Th ■■■ ku më parë është keqtrajtuar rëndë para familjarëve e më vonë, me automobilin e tij, e kanë dërguar në stacion policor në Kamenicë, ku, sipas urdhrit të të akuzuarit, është likuiduar në afërsi të Prishtinës, tek "Liqeni i Badovcit", ku si ekzekutues janë identifikuar Zh ■■■ F ■■■ dhe S ■■■ A ■■■.

Në këtë mënyrë dhe pa asnjë luhatje kanë dëshmuar edhe të gjithë dëshmitarët e tjerë, të cilët nuk e shohin të arsyeshme që dëshmitë e tyre të figurojnë në tërësi pasi që ato ekzistojnë në dokumentacionin e lëndës.

Në bazë të provave materiale, siç janë: raporti i personave të legjitimuar, në të cilin, në anën tjetër, janë të regjistruar personat me emër, me mbiemër dhe me lokacionin e shkruar në gjuhën serbe, me alfabetin cirilik, se të gjithë kanë qenë të paraparë për likuidim, nga kjo listë janë privuar nga jeta: I ■■■■■ I ■■■■■, N ■■■■■ K ■■■■■, A ■■■■■ Th ■■■■■, M ■■■■■ S ■■■■■, R ■■■■■ L ■■■■■.

Në bazë të raportit të SPB-së në Gjilan, i dërguar Prokurorisë Publike të Qarkut, vërtetohet fakti se me datën 27. 4. të vitit 1999, në fshatin Petrovc, janë gjetur kufomat e personave NN. T ë djegur sipas numrit të radhës së shtëpisë 193.

Ky raport i është dërguar Prokurorisë Publike të Qarkut për hulumtim. Në bazë të raportit të SPB-së së Gjilanit, pa numër, vërtetohet fakti se me datën 4. 5. të vitit 1999, në fshatin Bratilovc - Kamenicë, në afërsi të repetitorit televiziv, është gjetur kufoma e një personi të gjinisë mashkull, rreth 40 vjeçar, që i takon përkatësisë kombëtare shqiptare dhe se është i vrarë me armë zjarri.

Në bazë të procesverbalit mbi hulumtimin e vendit të ngjarjes KA. nr .36/99 i datës 14. 4. të vitit 1999, është vërtetuar fakti se një kufomë është gjetur në afërsi të Kamenicës, në drejtim të fshatit Strezovc, në afërsi të shtëpisë private me numër 221, në vendin e quajtur "Jaruga", kufoma i takon një moshe rreth 60 vjeçare , kurse shikimin e ka bërë Dr. M ■■■■■ A ■■■■■ nga Kamenica.

Në bazë të procesverbalit PP. nr. 44/ 99 të datës 4 maj të vitit 1999 është kryer hulumtimi i vendit të ngjarjes në fshatin Bratilovc, kufomë të cilën e kanë varrosur punëtorët e organizatës komunale.

Në bazë të procesverbalit numër 64/99 të datës 01. 05. të vitit 1999, të përpiluar nga punëtorët e organizatës komunale "Napredak" në Kamenicë, pasi është bërë hulumtimi i vendit të ngjarjes, shihet se punëtorët e kësaj organizate, pranë rrugës në drejtim të fshatit Koprivnicë, e kanë varrosur personin NN.

Në bazë të raportit mjekësor: Xh ■■■■■ L ■■■■■, I ■■■■■ B ■■■■■, R ■■■■■ R ■■■■■, Xh ■■■■■ R ■■■■■, fletë lëshimit të M ■■■■■ R ■■■■■, dhe raportit në emër të B ■■■■■ S ■■■■■, raportit mjekësor në emër të Z ■■■■■ D ■■■■■, është vërtetuar fakti se të gjithë këtyre personave iu janë shkaktuar lëndime të rënda trupore nga armë të zjarrit.

Në bazë të albumit të fotodokumentacionit të gjashtë fotografive në emër të R ■■■■■ M ■■■■■ shihen gjurmët e hunit në pjesë të ndryshme të trupit, që është rrahur

dhe keqtrajtuar rëndë deri në humbje të vetëdijes. Po ashtu, në bazë të një albumi tjetër me fotografi vërtetohet fakti i plaçkitjes dhe i djegies së shtëpisë dhe i hapësirave të tjera përcjellëse të auto shkollës "Jehona" në Kamenicë si dhe shtëpisë së M■■■■ Ke■■■■ nga Karaçeva e Ulët.

Nga dëshmitë e mbledhura dhe provat materiale, të shpjeguara në mënyrë posaçërisht të padyshimtë, është vërtetuar teza e aktakuzës, se këto prova janë të pakundërshtueshme, prej të cilave edhe rrjedh kualifikimi ligjor i veprës penale krime të luftës kundër popullatës civile nga neni 142, paragrafi 1 i LPJ, veprë penale të cilën i akuzuari e ka kryer me paramendim dhe pasojat i ka pranuar dhe se këto pasoja kanë rrjedhur nga vet urdhrat e dhënë dhe urdhrat të cilat i ka pranuar nga lart e i cili i ka kryer vet duke ua dhënë me rekomandim njerëzve të vet që të mos zgjedhin mjete për të arritur deri te qëllimi, kurse qëllimi final ka qenë zbrazja e këtyre fshatrave nga banorët të cilat ishin vetëm etnikisht të banuara e të cilat i kanë takuar kombit shqiptar me qëllim që me dhunë t'i dëbojë, gjë që edhe është vërtetuar se pjesa më e madhe e kësaj popullate e ka kaluar kufirin Kosovë-Maqedoni, deri sa pjesa tjetër ka mbetur në vend në ato fshatra ku represioni ka qenë i një intensiteti më të ulët, dhe me këto të dhëna me plotë të drejtë përfundoj se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale kriminale, krime të luftës kundër popullatës civile e kualifikuar sipas nenit 142, paragrafi 1 i LPJ, për çka edhe me plotë të drejtë kërkojmë që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënimin e merituar sipas ligjit.

Përkthyer nga përkthyesi gjyqësor:

Naile Keçmezi

PROKURORI PUBLIK I QARKUT

Sabit Maliqi